

## ***ABSTRAKT***

### **Përrjashtimi dhe Rekuizimi i Gjqqtarit në Procedurë Kontestimore**

**Kandidatja: Lomza Zhitija**

**Mentori: Prof. Dr. Rrustem Qehaja**

Përrjashtimi dhe rekuizimi i një gjyqtari në një procedurë kontestimore është një çështje mjaft e rëndësishme për të diskutuar sepse nga kjo çështje varet i gjithë sistemi gjyqësor. Qëllimi kryesor i sistemit gjyqësor është drejtësia e duhur në kontestet e palëve. Kur gjykatat kujdesen që vendimet që dalin nga ato të jenë të drejta dhe të paanshme, kjo krijon edhe besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor të vendit. Paanshmëria e gjyqtarëve luajn një rol tejet të rëndësishëm në vendimet përrfundimtare. Gjatë zhvillimit të procedurës, shpeshherë mund të paraqiten rrethana të cilat krijojnë dyshime tek palët në procedurë lidhur me veprimet e gjyqtarëve dhe në marrjen e përrfundimit vendimtar. Në krijim e këtyre rrethanave, legjislacioni i'u ka mundësuar palëve që të realizojnë të drejtën e tyre në paraqitjen e kërkesës për përrjashtimin e gjyqtarit nga procedura. Dispozitat ligjore të LPK-së kanë rregulluar arsyet apo rrethanat që sjellin tek përrjashtimi i gjyqtarit. Mirëpo përveç që janë të numruara taksativisht se cilat janë ato rrethana, shpeshherë paraqiten rrethana të tjera që ndikojnë në procedurën gjyqësore që zhvillohet e që këto rrethana sjellin deri tek rekuizimi i gjyqtarit. Përrjashtimi dhe rekuizimi i gjyqtarit në kontekst janë të njëjta, por janë rrethanat që i bëjnë të dallojn nga njëra tjetra dhe procedura e kërkesës për rekuizim duhet të jetë shumë më e detajizuar se ajo e përrjashtimit. Prandaj ky punim ka për qëllim që të bëhet analiza e këtyre rrethanave dhe të vërejmë se sa e rëndësishme janë edhe sjelljet e caktuara që gjyqtari i bën në procedurë sepse me rastin e emërimit, gjyqtari duhet të ketë gjithmonë parasysh të ruaj qetësinë, të kujdeset për shprehjet dhe sjelljet që i përdorë si dhe të ruaj integritetin e tij. Në këtë mënyrë, jo vetëm që krijohet besimi i palës te sistemi gjyqësor por edhe sistemi gjyqësor do të ketë autoritetin kur këto çështje trajtohen me kujdes dhe me korrektësi.

**Fjalët kyçe: Sistemi Gjyqësor, Gjyqtari, Paanshmëria, Palët, Përrjashtimi, Rekuizimi, Rrethanat, etj**

